



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

PROJEKT VENDIM

Nr. 5250, datë 22.4.2026

PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË NDËRMARRJES ‘LEZHA INVEST SH.P.K. TË STACIONEVE PUBLIKE TË PLAZHIT NË BASHKINË E LEZHËS’ DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT NË PLAZHET PUBLIKE NË ADMINISTRIM TË LEZHA INVEST

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 33, pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, nenit 55, nenit 64, shkronja “c” të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit” (i ndryshuar), nenit 6, 6/1, 9, 11 dhe 13 të Vendimit nr. 649, datë 16.10.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’, me qëllim përdorim të uniformuar të hapësirës publike stacion plazhi dhe krijimin e një mjedisi me shërbime të rregullta dhe funksionale turistike në shërbim të komunitetit, me propozim të subjektit Lezha Invest shpk Kryetari i Bashkisë;

PROPOZON:

1. Vënien në dispozicion të ndërmarrjes ‘Lezha Invest sh.p.k.’ në pronësi të Bashkisë Lezhë me NUIS M181165070 të sipërfaqeve publike stacione plazhi për shfrytëzim për ofrimin e shërbimeve turistike për pushues për sezonin turistik veror 2026.
2. Këto sipërfaqe i vihen në dispozicion për periudhën Maj 2026 – Tetor 2026.
3. Të miratojë në parim Plani i Veprimit i ndërmarrjes ‘Lezha Invest sh.p.k.’ bashkelidhur këtij projekt vendimi .
4. Të përcaktojë si tarifa tavan për ofrimin e shërbimit në stacione plazhi publike sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij projekt vendimi .
5. Ndërmarrja ka të drejtën që për ofrimin e shërbimit turistik të ndërtojë marrëdhënie ekonomike-financiare me operatorë që ofrojnë shërbime plotësuese.
6. Ndërmarrja nuk ka të drejtë ta ofrojë këtë hapsirë me qera operatorëve të tjerë apo ta shfrytëzojë bashkarisht me operatorë të tjerë.
7. Ndërmarrja ka detyrimin që të organizojë me shpenzimet e veta dhe në përputhje me Planin e vet të Biznesit shërbimet turistike në parcelat e sipërsënuara.

8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për hartimin e dokumentacionit dhe dorëzimin e hapsirës ndërmarrjes Lezha Invest sh.p.k. dhe organizimin e punës për inspektimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

9. Ky projekt vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 5250/1 prot.

Lezhë, me 22/04/2026

RELACION

MBI PROJEKT VENDIMIN E PARAQITUR :

“PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË NDËRMARRJES ‘LEZHA INVEST SH.P.K. TË STACIONEVE PUBLIKE TË PLAZHIT NË BASHKINË E LEZHËS” DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT NË PLAZHET PUBLIKE NË ADMINISTRIM TË LEZHA INVEST SH.P.K”

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 33, pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, nenit 55, nenit 64, shkronja “c” të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit” (i ndryshuar), nenit 6, 6/1, 9, 11 dhe 13 të Vendimit nr. 649, datë 16.10.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’, me qëllim përdorim të uniformuar të hapësirës publike stacion plazhi dhe krijimin e një mjedisi me shërbime të rregullta dhe funksionale turistike në shërbim të komunitetit, me propozim të subjektit Lezha Invest shpk Kryetari i Bashkisë i paraqet projekt-vendimin përkatës, Këshillit të Bashkisë;

Qëllimi i këtij Projekt Vendimi është përdorimi i uniformuar i hapësirës publike stacion plazhi dhe krijimin e një mjedisi me shërbime të rregullta dhe funksionale turistike në shërbim të komunitetit përmes shoqërisë ‘Lezha Invest sh.p.k’ që është në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Së dyti është mirëadministrimi i sipërfaqeve stacione plazhi publike dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për aksesin e publikut në shërbimet turistike të stacioneve të plazhit

Ky projekt vendim i ve ne dispozicion shoqërisë ‘Lezha Invest sh.p.k’ sipërfaqet publike në pronësi të Bashkisë Lezhë si strukturë përgjegjëse për administrim , menaxhim dhe mirambajtjen e plazheve publike .

në mënyrë që aktiviteti i shërbimeve turistike në stacionet e plazhit të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga publiku i gjërë.

Nw kuadër të përgatitjes së sezonit turistik veror 2026 ky projekt vendim ka si qëllim rishikimin dhe miratimin e tarifave për shërbimet e plazhit që ofrohen nga Lezha Invest sh.p.k. në zonat bregdetare nën administrimin e saj pasi rritja e cilësisë së shërbimeve, përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe përballimi i kostove në rritje kërkojnë një rishikim të strukturës aktuale të çmimeve.

Llojet e shërbimeve që do ofrohen në plazhet publike klasifikohen si më poshtë:

- Çadër kashtë /alumini + shezllong alumini

Ky është një shërbim bazë, i cili përfshin çadër prej materiali natyral (kashtë) ose alumini dhe dy shezllone alumini. Ofron një alternativë ekonomike për pushuesit.

- Çadër (kashtë/alumini) + shezllong druri me dyshek

Ky është një shërbim i kategorisë së mesme-lartë, që ofron rehati të shtuar përmes shezlloneve prej druri dhe dyshekëve.

- Gazebo plazhi familjare

Strukturë e dedikuar për familje ose grupe, me hapësirë më të madhe dhe nivel më të lartë komoditeti.

Në përcaktimin e tarifave të reja është marrë në konsideratë struktura reale e kostos për secilin lloj shërbimi, e cila ndryshon në varësi të materialeve, cilësisë dhe jetëgjatësisë së pajisjeve të përdorura.

Në mënyrë specifike:

- Shezllonet prej alumini përfaqësojnë një kosto më të ulët investimi fillestar, por kanë nevojë për mirëmbajtje më të shpeshtë dhe kanë një jetëgjatësi më të kufizuar në kushtet e përdorimit intensiv në plazh.

- Shezllonet prej druri me dyshek kanë një kosto më të lartë blerjeje, për shkak të materialit, përpunimit dhe nivelit të komfortit që ofrojnë. Gjithashtu, ato kërkojnë kujdes dhe mirëmbajtje më të specializuar, duke rritur kostot operative.
- Çadrat prej kashte kanë kosto më të ulët instalimi, por kërkojnë zëvendësim më të shpeshtë për shkak të konsumimit nga kushtet atmosferike.
- Çadrat prej alumini kanë kosto më të lartë fillestare, por ofrojnë qëndrueshmëri dhe përdorim afatgjatë, duke ulur kostot në periudhë më të gjatë.
- Strukturat “gazebo” familjare përfaqësojnë investimin më të lartë, pasi përfshijnë materiale më të forta, sipërfaqe më të madhe dhe kapacitet më të lartë shërbimi.

Çmimi i shërbimeve është ndikuar drejtpërdrejt nga:

- çmimi i marrjes me qera të shezlloneve dhe çadrave në treg
- kostot e transportit dhe montimit
- amortizimi sezonal i pajisjeve
- kostot e punës për administrimin dhe mirëmbajtjen

Në këtë kuadër, është konstatuar një rritje e çmimeve të furnizimit për pajisjet e plazhit në krahasim me sezonet e mëparshme, çka e bën të domosdoshëm rishikimin e tarifave për vitin 2026.

Diferencimi i çmimeve ndërmjet paketave të shërbimit dhe ndërmjet zonave gjeografike bazohet në:

- nivelin e investimit për secilin lloj pajisjeje
- cilësinë dhe komoditetin që ofrohet për pushuesit
- jetëgjatësinë dhe kostot e mirëmbajtjes
- kërkesën e tregut për kategori të ndryshme shërbimi

Tarifat e propozuara sipas zonave turistike parashikohen te jene si me poshte sipas llojit te sherbimit dhe sipas zonave gjeografike :

Ne leke/dite

Lloji i sherbimit	Tale +Vain	Shengjin	Rana e Hedhun
Çader kashte/alumini + Shezlong alumini- varianti ekonomik	300	400	500
Çader alumini / kashte + Shezlong me profile druri me dyshek	700	800	1000
Gazebo plazhi- <i>familjare</i>	1,500	2,000	2,500

Kjo strukturë tarifore synon të ofrojë alternativa për të gjitha kategoritë e pushuesve, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmëri financiare për ndërmarrjen.

Përfitimet nga miratimi i tarifave të reja:

- Rritje e cilësisë së shërbimeve turistike
- Administrim më efikas i hapësirave publike
- Përmirësim i imazhit të zonave turistike të Bashkisë Lezhë
- Shtim i të ardhurave për investime të mëtejshme
- Ofertë më e strukturuar dhe transparente për pushuesit

Duke marrë në konsideratë faktorët ekonomikë dhe zhvillimin e sektorit turistik, propozohet që Këshilli Bashkiak Lezhë të miratojë tarifat e reja për shërbimet qe ofrohen ne plazhet publike për sezonin veror 2026, sipas tabelës së mësipërme.

Ky vendim do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në territorin e Bashkisë Lezhë.

KRYETAR

PJERIN NDREU



Lidhja nr 1

TARIFAT MAKSIMALE PËR OFRIMIN E SHERBIMIT NË STACIONET E PLAZHIT

Lloji i sherbimit	Në lekë/ditë			Varianti
	Tale +Vain	Shengjin	Rana e Hedhura	
Çader kashte/alumin + Shezlong alumini	300	400	500	ekonomik
Çader alumini / kashte + Shezlong me profile druri me dyshek	700	800	1,000	Cilesor
Gazebo plazhi- <i>familjare</i>	1,500	2,000	2,500	Premium